

# H Y L L I I D R I T Ë S

## E PËRKOHSHME KULTURORE - LETRARE

---

---

### *EDITORIAL*

Vlera e mendimit vetjak 3

### *GJUHËSI*

#### **Bardhyl DEMIRAJ**

Grimca biografike për autorët tanë të vjetër 6  
V. Ndue Babi (1659 – 1728)  
VI. Gjergj Engjëll Radovani (1733-1790)  
VII. Vincenzo Basile SJ (1811-1882)

#### **Evalda PACI**

Kuvendi i Arbënit (1703), një kapërcyell i rëndësishëm 50  
në historinë e shkrimit shqip

### *STUDIME LETRARE*

#### **Martin CAMAJ**

Aktualizimi i poezisë fishtjane 60

#### **Alfred ÇAPALIKU**

Afri e dallime mes Camajt e Ungarettit 65

#### **Lisandri KOLA**

*Mbreti i Tules* nga Ndré Mjedja 69  
(paradigma karduçiane e përkthimit)

#### **Tringë DUKAGJINI**

Simfoni 78

*STUDIME HISTORIKO-LETRARE*

**Ledri KURTI**

At Zef Valentini dhe Shqipëria brenda tij 87

*ARKEOLOGJI*

**Gëzim HOXHA**

Kisha e "Shën Mëria e të Ngjitunit në Qiell" e Kaçës dhe Naraçit 96

*HISTORI*

**Lucia NADIN**

Venezia, anno 1503: concessione di Arche di Sepoltura alla Scuola degli Albanesi nel primo Chostro del Convento dei Frari. Il dato in un complesso scenario 111

**Edmond MALAJ**

Dëja në Mesjetë 122

**Paulin MARKU**

Ndihma e Italisë në ngritjen e ekonomisë shqiptare gjatë viteve (1925-1932) 149

*BRILANTE BIBLIKE*

**Át Daniel GJEÇAJ, OFM**

Libri i Fjalëve të Urta (Proverbave) 164

*BOTIME TË REJA - REÇENSIONE*

**Anila OMARI**

"Doktrina e kërshen" e Gjon Kazazit dhe botimi kritik i saj (Shënime mbi librin e Bardhyl Demirajt "Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij, ASHAK, Prishtinë, 2006) 190

*NEKROLOGJI*

Willy Gjon Kamsi (1926-2017) 198

*ARKIVI I HYLLIT*

**Át Anton HARAPI, OFM**

Letër-qarkore drejtue famullitarëve të Provincës Françeskane Shqiptare 200

**Át Donat Kurti, OFM**

Nji permbledhje e shkurtë rregullash njerziet 213

*Vëzhgim redaksional*

Në këtë vit jubilar të 25-vjetorit të ndarjes nga jeta të Martin Camajt (1920-1992) redaksia e Hyllit të Dritës vendosi të botojë – me lejen e zonjës Dr. med. Erika Camaj – tekstin origjinal të një kumtese të mbetur në dorëshkrim, të cilën autori, i rënduar në gjendjen e tij shëndetsore, e kishte përgatitur për ta lexuar në Shkodër më 23 tetor 1991. Ky shkrim përcjell natyrshëm jo vetëm kandin e stilit të thukët të shkrimtarit tonë të madh në rolin e kritikut letrar të spikatur por edhe atë qerthull problemesh të mprehta, me të cilat përballen sot e gjithë ditën rrethet letrare të grupmoshave të ndryshme në kohën tonë të tranzicionit kulturor. Njohja dhe mirënjohja e traditës letrare shqiptare, e sendërtuar më së miri në pendën e Poetit tonë kombëtar, janë për Camajn vetëm pjesë e këtij qerthulli që ka kapluar si i tillë kulturën e kujtesës kolektive<sup>1</sup>.

MARTIN CAMAJ

### Aktualizimi i poezisë fishtjane<sup>2</sup>

Fjala ‘aktualizim’ na qet ndërmend kthimin tek një proces i nisun dhe i këputun në një shëj vendi. Ndoshta dikush mendon se vijimësia, rimarrja e procesit mbërrihet tue marrë të dy fijet e këputuna e ngjiten bashkë, bile tue lidhë nye po aty [ku] janë këputë para afër një gjysmë shekulli. Don me thanë zhvillimi i traditës kulturore ndër ne i këputun nuk ka shembull anaçor në asnjë kulturë të popujve që dalin nga diktatura staliniane dhe kërkojnë rrugë kthimi në traditën e vet të mirëfillt. Rasti ynë ashtë i veçantë, për ju të breznisë së re posaçe. Juve ju mbetet të filloni një proces të ri, pra, ta aktualizoni traditën në kushte të reja. Edhe Fishta do lexue përsëri, jo vetëm Shkodër, por edhe në Tiranë, Vlorë e Korçë. Ju të lindun në pjesën e dytë të këtij shekulli në trollin tonë amë, amë edhe për ne të diasporës, *Fishta* iu tingllon si emën abstrakt nëse nuk e lidhin me një emën vendi *Fishtë*, katund i Zadrimës ku lindi Poeti ynë.

Para se të kaloj në shqyrtimin e temës së dhanun nalt, si nis me jetue vepra artistike e ndalueme këtu tek ju, due të sjelli vërejtjen se

<sup>1</sup> Hylli i Dritës falënderon studiuesin dhe bashkëpunëtorin e censhëm prof.dr. Bardhyl Demiraj për përgatitjen e kujdeshme për botim të këtij studimi fort të çmueshëm të Martin Camajt.

<sup>2</sup> Kumtesë e përgatitun për t’u lexue para Shoqatës “At Gjergj Fishta” më 23 tetor 1991 në Shkodër.

Fishta në diasporën shqiptare të shprishun nëpër botë e vepra e tij nuk është qitë kurr në harresë. Mbas 1950 *Lahuta e Malcis* u botue dy herë në mija ekzemplare në Romë dhe i treti botim gjindet në shtyp në një Editori kosovare. *Lahuta* u përkthye gjermanisht nga albanologu i përmendun Max Lambertz, i cili ishte profesor i universitetit të Leipzig-ut, në zonën-komuniste. Qeveria e Enver Hoxhës ndërhyri që *Lahuta* e përkthye mos të botohet në DDR (RP Gjermane), andaj doli në dritë në Gjermaninë Perëndimore (Botues: Südosteuropa Institut. R. Oldenbourg Verlag. München 1958). Kangë të ndryshme të *Lahutës* si edhe shumë copë nga satira e Fishtës kanë qenë përkthye prej Ernest Koliqit dhe botue herë mbas here në revistën letrare "Shêjzat - Le pleiadi" në Romë (1957-1974) *Lahuta* tanësisht e përkthye doli në Palermo në vjetet '60; përkthyesi Ignazio Parrino: albanolog arbëresh dhe dishepull i prof. Zef Valentinit, drejtor i "Istituto di Studi Albanesi" – Università di Palermo.

Për Fishtën në këtë ndërkohë kanë shkruar studiues të shquem, ndër ta del në pah prof. Arshi Pipa i Universty of Minnesota (USA) (sh. Trilogia albanica, në 3 vëllime, 1978. München) etj. Këtu po marr rastin t'ju vë në dukje se disa përkthime të Arshi Pipës në gjuhën anglishte janë dëshmi e madhshtisë së vargjeve të Fishtës si në asnjë përkthim në ndoj gjuhë tjetër. Pipa është edhe autor i tri veprave poetike, botue në mërgim: *Libri i burgut*, *Rusha* e *Meridiana*. Ka botue mija faqe gjithnjë në gjuhën anglishte mbi letërsinë shqipe, mendimin filozofik dhe estetik të spiritualitetit apo pajës shpirtnore shqiptare. Po shfrytëzoj këtë rast, por tue mbetë gjithnjë mbrenda temës, të theksoj se pa veprat e Arshi Pipës nuk mund të lidhet filli i këputun i traditës letrare ndër ne. Për këtë pinjuell të qytetit tonë, të Shkodrës; duhet të jeni krenarë!

Fishta si figurë e shkëlqyeshme e letërsisë dhe e kulturës shqiptare ka qenë dhe është gjithnjë në qendër të vëmendjes së shkencës në të gjitha qendrat universitare albanologjike në Perëndim, Romë, Neapull, Palermo, Kozenca, Bari, Mynih, Minneapolis, Minnesota (USA) etj. Mbi veprat e Fishtës janë shkruar dhjeta teza doktorati. Fishta ka hy me kohë në letërsinë botnore, posaçë në studime e monografi specifike rreth epikës botnore, meqenëse Poeti ynë në këtë gjini letrare zë vend të posaçëm: *Lahuta e Malcis* mbahet si vepra e fundit epike në kontinentin tonë. Artikuj mbi Fishtën dalin sot e gjith ditën në enciklopedi letrare në tanë botën.

Tash ju, brezni e re shqiptare, gjindeni para një vepre mija e mija faqesh të Poetit ma të madh tonin, i cili për afër një gjysmë shekulli ju iau hoqën sysh shi asi njerëzish të paaftë me gjykue çka është art e poezi, po se po, por edhe pa vlera morale e patriotike shqiptare, tipa Tartufash që simbas Fishtës edhe në kohën e tij kishin këso parimesh:

Ti ke mbajtur  
Gjithmonë këtë rregull:  
Erzin e shpirtin  
Do t'losish shrregull  
Do t'i shesish vllazent,  
Do t' mohojsh fisin,  
Sá herë qi n' shekull  
T'a leverdisin  
(Anzat e Parnasit)

Ku do t'ia filloni ta zbërtheni gërshetimin kompleks të mbarë veprës së Fishtës, mes epikës, lirikës, ironisë e satirës? Shpejt do të kujtoheni se Fishtën e madh nuk do ta zbuloni vetëm me *Lahutën e Malcisë*, ndonëse zbulimi i kësaj vepre na jep në dorë fillin për zbulimin jo vetëm të një periudhe, por të mbarë traditës letrare tonë, andaj të gjitha veprat fishtjane që përfshijnë të gjitha gjinitë letrare donë pamë e analizue në kontekste të gjana të letërsisë dhe të poetëve tanë; me De Radën, për shembull në lirikë dhe epikë.

Gjergj Fishta dhe Jeronim De Rada janë klasikët tanë që lidhën traditën letrare gojore popullore, me siguri një traditë letrare mija vjetësh, me letërsinë reflekse apo individuale të shkrueme. Në të dy spikat talenti i shkrimjes të këtyne dy komponenteve më një, po ashtu si zbulohet qartë në përpunimin e vargut të poezisë popullore (sh. Pipa, *Albanian Folk Verse: Structure and Genre*, 1978). Tek të dy këta poetë spikat një varg i ripërtrimë, i ri, në një shkëlqim të paimitueshëm, të papërsëritshëm. Këtë vijimësi nga burimi i gjenit të kombit e gjejmë edhe në funksionin e këtij arti nga rrezaton vetëdija se kush jemi si *arbënorë* dhe si të tillë në çfarë rreziku gjindemi për të mos qenë ata që jemi. Breznia juej ashtë e stërvitun të përnjësohet me një tjetër funksionalizim të letërsisë që nuk ishte dhe nuk ashtë e përgjithshme shqiptare, por në interesin e mbijetesën e një klike. Kalimthi po theksoj: poezia popullore dhe e klasikëve do kuptue si britje e dhimbshme, gjamë e vajtim grash zemërplasuna që gj[th]mbarë britje e dhimbë integrohen në poezin e Fishtës sonë. Në sajë të këtij kunorzimi, përputhjes të kangës në zanin e një populli dhe të shëjit simbolik që shlyhet në lëkurë e gur, por del përsëri (sh. Palimpsest 1991) Andaj me të drejtë pohojmë edhe na vetë se jemi trashigues kulturash të ndryshme të rralla në botë. Më falni për këtë shpërthim ndjesish në një tekst analizues! Fishtës posaçe ma tepër se De Radës i mjafton vetëm një fjalë, një theksim në sistemin tingullor të vargut popullor, për ta ba atë specifik, të papërsëritshëm, origjinal me vulën e artit fishtjan. Në një lloj të tillë të vargut epik, rapsodi i maleve tona sa ta ndëgjojë, brof e thotë: ky ashtë Fishta!

Si te De Rada ashtu edhe te Fishta hasim në vargje popullore autentike, të paprekuna, por që integrohen natyrshmënisht në strukturën tekstuale të veprës së tyre. Kjo metodë e poetëve tanë i përgjason asaj të kompozistëve të mëdhaj të muzikës klasike, të cilët kur tematizojnë motive thjesht folklorike popullore, në një shëj vendi integrojnë në partiturë apo tekst motive të ralla tingujsh po ashtu si gjinden në varianten popullore, ndoshta sepse këto pjesë burimore të muzikës apo kangës popullore në të dy rastet, në vetvete kanë mbërritë përsosmëninë dhe së dyti si të tilla përkojnë me harmoninë e saktë në strukturën kompozicionale të pjesëve të elaborueme.

Problem për kuptimin e poezisë fishtjane si të çdo autori tjetër të madh në letërsinë tonë, Poradeci apo Mjeda dhe në kohët e reja Mitrush Kuteli, për shembull, paraqet *forma*, kryekreje *gjuha* e lidhun ngusht me stilin vetjak të poetit (*language*). Dukuni e përgjithshme për të gjitha vendet e diktaturës staliniste, me pak përjashtime si janë gjuhët me traditë të gjatë kulturore, ashtë formalizimi i gjuhës në një drejtim të caktuem për ta ba atë mjet e vegël përçuese të propagimit të doktrinës dhe praktikave të shtresës sunduese. Karakteristikë e këtij zhvillimi gjuhësor të panatyrshëm ashtë cungimi i pjesëve të gramatikës, zvetnimi i gjuhës përmes marifeteve tjera manipuluese që nuk kanë të bajnë me shkencën e mirëfilltë gjuhësore, quejtë me një terminus technicus lingvistik komponente “jashtagjuhësore”. Kjo gjuhë artificiale, natyrisht, nuk mund të merret as si bazë formale krahasuese në studime të historisë së gjuhës shqipe prej asnjë shkencatari të saktë. Ideologjia monike kishte nevojë për një kufizim apo ngushtim formash, për vorfnimin e gjuhës, për të ngushtue edhe mendimin e lirë që lyp një fjalor të llojllojshëm ashtu si i ka gjuha shqipe.

Vetëm me gjuhën gazetareske të propagandës nuk mund të kuptohet asnjë autor shqiptar cilësor, për mos me shkue larg, as veprat e fundit të Mitrush Kutelit. Disa autorë të realizmit socialist sa ma tepër shtyhen në zgjanimin e përmbajtjeve dalin si pa u kujtue edhe jashta hallkave formale të gjuhës ‘njësuar’, andaj veprat e autorëve mediokrë (si i quen shtypi sot) ishin të përkrahun nga klika sunduese enveriste. Veprat e tyre ishin për klikën të tejpashme të përshtatshme për ta shndërrue njerinë në robot.

Tek unë dhe ata që e kanë ndjekë zhvillimin e kësaj lloj letërsie disi për së largu por vijueshmënisht qet kryet kujdesi që në këto kushte ‘aktualizimi’ i autorëve mos të marrë drejtim të gabuem. Rrezik për gjeneratet e reja në përvetësimin dhe receptimin e klasikëve mos të ndahet përmbajtja nga forma. Kjo na qet edhe në një plan tjetër të shqyrtimit: tek Fishta, për shembull, mbivlerësohet funksioni patriotik dhe s’kujtohem se Fishta së pari ashtë poet i madh. Fishta u gjykue

gabimisht edhe nga disa autorë të realizmit socialist ndoshta edhe mbushamendas, sepse ata s'e panë *Lahutën e Malcis* në kontekstin e letërsisë të një periudhe mbasrindëse. Vepra fishtjane shënon një kthesë pa të cilën nuk do të kishte pasë zhvillim të matejshëm poezia jonë. Fishta vë në dukje, për shembull, problemet mbas krijimit të shtetit shqiptar, korrupsionin si trashigimi e byrokracisë otomane përmes nëpunësve që Turqia e re "i hodhi si këlbazën" jashtë dhe si patriotë shqiptarë gjoja, shtypnin popullin mbas praktikës otomane të vjetër. Në vlerësimin funksional, Fishta për kohën e tij ashtë ma tepër *social se nacionalist* në kuptimin e lashtë të fjalës.

Breznitë e reja shqiptare gjinden para mundësive të reja që edhe përmes poezisë të klasikëve tanë të përvetësojnë cilësitë estetike të lira e të natyrshme e që andej të nisen rrugëve të reja në zbulimin e jetës e të artit tonë të *ethnos-it*, skajim që përfshin të gjithë botën shqiptare.